



British Embassy
Skopje



PROJEKTI LLOGARIDHËNIE NËPËRMJET ANGAZHIMIT QYTETAR

Thirrje për aplikime

Grante për organizatat e shoqërisë qytetare

Afati i fundit për dorëzim: 24 tetor 2016

HYRJE

Projekti Llogaridhënie nëpërmjet angazhimit qytetar (LLAQ) ka për qëllim ta mbështesë krijimin e mekanizmit që do t'u mundësojë organizatave të shoqërisë qytetare dhe qytetarëve të angazhohen për transparencë dhe llogaridhënie të institucioneve, nëpërmjet aktivizmit qytetar, angazhimit ose implementimit të iniciativave të mbështetura nga komuniteti në fushën e sundimit të së drejtës, qeverisjes së mirë dhe kohezionit social.

Ky projekt do të ofrojë mbështetje për *fushata të përfaqësimit për qëllime të caktuara dhe për iniciativa për politika* që do të kontribuojnë për arritjen e këtyre qëllimeve të përgjithshme:

- Rritjen e përfshirjes së shoqërisë qytetare në krijimin e mendimit publik, krijimin e politikave dhe pjesëmarrjen në mekanizmat e vendimmarrjes;
- Rritjen e kapaciteteve të shoqërisë qytetare për të krijuar mbështetës të tyre dhe për t'u ballafaquar me çështjet që kanë të bëjnë me llogaridhënien, transparencën dhe kohezionin social.

Metamorfozis e shpall këtë Thirrje për aplikime për të ofruar mbështetje për organizatat e shoqërisë qytetare për t'u ballafaquar me çështjet që kanë të bëjnë me llogaridhënien, transparencën dhe kohezionin social dhe për ta promovuar qeverisjen e mirë mëpërmjet skemës për grante në vlerë prej **44,000 funtave britanikë** duke ndarë përafërsisht 10 grante të vogla për organizatat e shoqërisë qytetare (OSHQ) në Maqedoni (në vlerë ndërmjet 2000 funtave britanikë dhe 5000 funtave britanikë).

KARAKTERISTIKAT E GRANTIT

Me këtë Thirrje për aplikime, do të ndahen grante për OSHQ-të. Aktivitetet e mbështetura me këto grante kanë për qëllim të promovojnë një shoqëri qytetare dinamike e cila i mobilizon qytetarët në mënyrë efektive për angazhim aktiv në çështjet e qeverisjes së mirë dhe kohezionit social dhe që ndikon në proceset e politikave dhe të vendimmarrjes në nivel lokal dhe nacional. Ky lloj i grantit do t'i mbështesë OSHQ-të ose grupet joformale për t'i mobilizuar dhe për t'i angazhuar qytetarët me shpejtësi për ndonjë çështje aktuale me rëndësi në nivel lokal ose nacional.

Këto grante do t'i mbështesin iniciativat që kanë për qëllim zgjerimin e njohurive dhe të kontrollit publik mbi punën e institucioneve publike, si dhe aksionet qytetare që do t'i trajtojnë/promovojnë vlerat e bashkësisë që kanë të bëjnë me sundimin e të drejtës, qeverisjen e mirë dhe kohezionin social. Produktet e projekteve të mbështetura duhet t'i prezantojnë informatat e ndërlikuara në mënyrë të thjeshtë, duke e promovuar idenë se informacionet publike nuk janë pronë e një institucioni, por një vlerë që menaxhohet nga institucioni në emër të qytetarëve. Do të mbështeten intervenime nga OSHQ-të dhe aktivistët në kohën e duhur duke i stimuluar ato që t'u shërbejnë komuniteteve të tyre në mënyrë më efektive dhe t'i mobilizojnë qytetarët për ta përmirësuar situatën sociale-ekonomike dhe atë politike. Këto aksione duhet t'i vënë në lëvizje aktorët e shoqërisë qytetare për çështje të rëndësishme.

Aplikuesit duhet të demonstrojnë përkushtim për të bashkëpunuar me OSHQ-të e tjera, grupet qytetare dhe palët e ndryshme të interesuara në bashkësitë e tyre përkatëse. Nga aplikuesit dhe aktivitetet e projektit pritet ta promovojnë barazinë gjinore dhe diversitetin etnik.

Këto grante duhet të kontribuojnë për arritjen e këtyre qëllimeve të përgjithshme të projektit:

- Rritjen e përfshirjes së shoqërisë qytetare në krijimin e mendimit publik, krijimin e politikave dhe pjesëmarrjen në mekanizmat e vendimmarrjes;
- Rritjen e kapaciteteve të shoqërisë qytetare për të krijuar mbështetës të tyre dhe për t'u ballafaquar me çështjet që kanë të bëjnë me llogaridhënien, transparencën dhe kohezionin social.

Këto grante mund të jenë në vlerë prej **2,000 funtave britanikë deri në 5,000 funta britanikë**. Të gjitha projektet duhet të përfundohen jo më shumë se **pesë muaj** pasi të jetë nënshkruar marrëveshja për ndarjen e grantit.

Fushat prioritare për intervenim janë:

- **Njohuritë elementare mediatike** – projekte joformale edukative që i përmirësojnë njohuritë dhe shkathtësitë e qytetarëve për ta dalluar dhe për t'u përballur me propagandën kundrejt informimit. Trajnime në nivel lokal për të rinjtë dhe qytetarët e moshës së mesme.
- **Shërbimet publike në nivel lokal** – projekte që kanë të bëjnë me mbështetjen dhe përforcimin e shërbimeve sociale lokale që i synojnë drejtpërdrejt qytetarët që kanë nevoja.
- Projektet për përmirësimin e **shëndetit publik të grupeve të marginalizuara**, duke përfshirë trajnime joformale ose angazhime afatshkurta të praktikantëve, studentëve të fakulteteve përkatëse (mjekësisë, farmacisë, sociologjisë, psikologjisë).
- **Llogaridhënia dhe financat publike** – monitorimi i llogaridhënies së autoriteteve lokale. Monitorimi i shpenzimeve publike duke i analizuar raportet për transferet sociale dhe fondet që i ndahen sektorit qytetar lokal.
- **Sundimi i të drejtës dhe drejtësia** – ofrimi i shërbimeve për qytetarët që do t'u ndihmojnë atyre në kërkimin e drejtësisë në nivel personal ose grupor. Këtu bëjnë pjesë të drejtat e punëtorëve dhe të drejtat e tjera sociale, barazia gjinore, mbrojtja e shëndetit, qasja në drejtësi, (mos)diskriminimi, monitorimi strategjik i proceseve gjyqësore.
- **Përforcimi i qëndrueshmërisë së OSHQ-ve** – projekte që nxisin gjenerimin e të ardhurave, si dhe promovimin e rëndësisë së sektorit qytetar dhe shërbimeve që i ofron ai duke e ngritur vetëdijen dhe duke bërë edukimin publik të popullatës lokale.
- **Mbrojtja e ambientit për jetesë** – projekte që stimulojnë aksione lokale ekologjike nëpërmjet rrjetëzimit të OSHQ-ve lokale.

- **Integrimi i të rinjve** – t’u mundësohet të rinjve të shpërndajnë informata (mediet rinore); ta ushtrojnë të drejtën e tyre për shoqërim nëpërmjet OSHQ-ve lokale, këshillave rinore dhe formave të tjera të rrjetëzimit; integrimi i të rinjve dhe tejkalimi i pengesave dhe i paragjykimeve ndëretnike; përforcimi i kapaciteteve të të rinjve për përfaqësim të bazuar në fakte, veçanërisht sa i përket cilësisë së sistemit arsimor; ndihmës ligjore dhe arsimit ligjor të të rinjve që merren me çështjet e sistemit arsimor; përgatitja e të rinjve për t’u bërë pjesë e fuqisë punëtore – zhvillimi joformal i shkathtësive të nevojshme për punësim.
- **Kohezioni social** – projekte që kontribuojnë për tejkalimin e pengesave dhe të paragjykimeve ndëretnike; do të mbështeten iniciativat që përmirësojnë aspekte të caktuara të kohezionit social në shoqërinë tonë.

NDIHMA TEKNIKE DHE RRJETËZIMI

Pasi të ndahen grantet, Fondacioni Metamorfozis do ta mbikëqyrë implementimin e granteve dhe do të ofroj ndihmë teknike për të gjithë ata që kanë fituar grante për projektet duke u bazuar në nivelet e tyre të veçanta të kompetencës.

Qasja e skemës për grantet e vogla është e tillë që dizajnimin dhe implementimin e projekteve të granteve do ta trajtojë si proces mësimi, veçanërisht për OSHQ-të më të vogla. Aplikuesve do t’u ofrohet mbështetje me informata kthyesë konstruktive në të gjitha fazat e projektit të grantit – duke filluar që nga propozimi i tyre i projektit, gjatë zhvillimit të planit të tyre aksional, e deri te menaxhimi i përgjegjshëm i mjeteve financiare të grantit.

BASHKËFINANCIMI

Bashkëfinancimi i 5% të çdo aktiviteti është i pëlqyeshëm, mirëpo nuk është kërkuar patjetër për të marrë pjesë në thirrjen për të aplikuar në projektin LLAQ. Aplikuesit që do të ofrojnë bashkëfinancim, veçanërisht nga komunat e synuara, do të kenë përparësi gjatë procesit të përzgjedhjes në kuadër të skemës së grantit. Aplikuesit do të inkurajohen që të ofrojnë mbulim të një pjese të harxhimeve nga burimet e tyre ose nga burime/donatorë të tjerë.

Bashkëfinancimi që do të merret parasysh duhet të përbëhet vetëm nga kontributi financiar që është i nevojshëm për arritjen e rezultateve të projektit dhe që mund të vërtetohet nga evidenca e pranuesve të granteve. Kontributet jofinanciare (mallra, shërbime etj.) nuk mund të konsiderohen si bashkëfinancim, mirëpo do të theksohen gjatë procesit të vlerësimit.

PROCESI I VLERËSIMIT

Kjo Thirrje për aplikime do t’i mbështesë propozimet novative dhe të guximshme që:

- a) I mbështesin drejtpërdrejt qëllimet e projektit LLAQ;
- b) Demonstronë përkushtim për t'iu qasur qytetarëve dhe për t'i përfshirë ata;
- c) Ofrojnë strategji kreative dhe efektive për qasjen në informata dhe për dhënien e informatave për politikën
- d) Mundësojnë shfrytëzim strategjik të medieve tradicionale dhe atyre të reja për mobilizimin e organizatave të vogla në terren dhe angazhimin e qytetarëve;
- e) Mundësojnë shfrytëzim novativ të të dhënave të hapura dhe teknikave për vizualizim
- f) Promovojnë qasje integruese me fokus të veçantë në përkatësinë etnike dhe gjininë
- g) Kultivojnë partneritete dhe koalicionet, veçanërisht gjatë përballjes me çështje të rënda.

OSHQ-të do të duhet t'i dërgojnë aplikimet e tyre duke e përdorur **Formularin standard për aplikime të Fondacionit Metamorfozis**, duke përfshirë **Planin preciz për implementim** dhe **Formularin e buxhetit** dhe dokumentet e rëndësishme të bashkangjitura: kopjen e dokumenteve për regjistrimin e OSHQ-së, raportet vjetore përshkuese dhe financiare për vitin e kaluar, raportin e revizionit, biografite të të punësuarve kryesorë, informatat për partnerët dhe letrat e përkushtimit – në qoftë se ka.

Përzgjedhja e pranuesve të granteve do të bëhet në kuadër të një procesi me tre hapa: vlerësimi paraprak, vlerësimi dhe ndarja e grantit. Çdo aplikim do të vlerësohet paraprakisht për t'u siguruar se janë plotësuar kërkesat themelore dhe se aplikimi është në përputhje me kriteret e përshtatshmërisë, si më poshtë:

- Aplikuesi duhet të jetë OQSH e regjistruar në Republikën e Maqedonisë
- Formulari për aplikim të jetë plotësuar në tërësi dhe të jenë bashkangjitur të gjitha dokumentet e nevojshme
- Aplikimi të dërgohet para se të përfundojë afati i fundit për dorëzim
- Mbështetja e kërkuar financiare të mos e tejkalojë vlerën maksimale të grantit të vogël

Aplikimi duhet t'i plotësojë të gjitha këto kritere që të mund të kalojë në fazën e vlerësimit. Aplikimet që nuk do t'i plotësojnë kriteret do të refuzohen.

Këto aplikime do të kenë prioritet gjatë procesit të përzgjedhjes:

- Aplikimet që kanë siguruar bashkëfinancim prej së paku 5% të shpenzimeve të përgjithshme të aksionit;
- Aplikimet nga organizatat e vogla nga terreni dhe OSHQ-të e vogla (me buxhet vjetor më të vogël se sa 30.000 euro gjatë tre viteve të fundit)
- Iniciativat kreative dhe efektive në aspekt të shpenzimeve me potencial të lartë për qëndrueshmëri afatgjate.

Të gjitha aplikimet që do të vlerësohen pozitivisht gjatë procesit të vlerësimit paraprak do t'i përcillen Komisionit për përzgjedhje për miratim/refuzim/miratim me kusht. Komisioni për përzgjedhje do t'i vlerësojë aplikimet në bazë të këtyre **kritereve për përzgjedhje**:

1. Qasja teknike (maksimum 60 pikë)
 - Rëndësia në raport me nevojat dhe çështjet e trajtuara (30 pikë)
 - Cilësia e aktiviteteve të propozuara (15 pikë)
 - Aktivitetet e orientuara kah rezultatet (15 pikë)

2. Kapaciteti i organizatës dhe puna në të kaluarën (maksimum 20 pikë)
 - Kapacitetet administrative, financiare dhe menaxhuese (10 pikë)
 - Përvoja e rëndësishme në të kaluarën dhe rezultatet në fushat e ngjashme (10 pikë)

3. Propozimi i shpenzimeve (maksimum 20 pikë)
 - Efektiviteti i buxhetit në aspekt të shpenzimeve (10 pikë)
 - Aftësia adekuatë për menaxhment financiar (10 pikë)

Grantet do t'u ndahen vetëm pranuesve të përgjegjshëm që posedojnë potencial për të punuar me sukses në kuadër të kriterëve dhe kushteve të projektit LLAQ. Do të merren parasysh çështjet siç janë integriteti, dosja e punës në të kaluarën, burimet financiare dhe teknike, dhe qasja në burimet e tjera të nevojshme.

Gjatë procesit të vlerësimit, Komisioni për përzgjedhje do ta ketë lirinë të kërkojë informata plotësuese nga aplikuesit në lidhje me propozimin ose për organizatën në përgjithësi, që janë të nevojshme për ta përfunduar vlerësimin. Po ashtu mund të realizohen edhe vizita te organizatat aplikuese para se të ndahet granti.

Aplikuesve do t'u dërgohen letra të miratimit, refuzimit ose miratimit me kusht. Aplikimet e miratuara do ta pranojnë Kontratën për ndarjen e grantit ku do të theksohen obligimet ligjore të organizatës që e pranon grantin, që do të bazohet në planin për implementim nga aplikimi i dërguar.

DËRGIMI I APLIKIMEVE

Aplikimi i kompletuar duhet të dërgohet në dy kopje të shtypura në letër të formatit A4 në gjuhën maqedonase, duke përfshirë edhe një përmbledhje të shkurtër në gjuhën angleze. Poashtu duhet të dërgohet edhe një CD me versionin elektronik të të gjitha dokumenteve. Versionet e shtypura në letër dhe ato elektronike duhet të jenë identike.

OQSH-të duhet t'i dërgojnë aplikimet e tyre duke e përdorur **Formularin standard për aplikim të Fondacionit Metamorfozis**, duke përfshirë:

- Planin për implementim
- Formularin për buxhetin dhe dokumentet e tjera të rëndësishme të bashkangjitura,
- Kopje të dokumenteve të regjistrimit të OQSH-së,
- Raportet vjetore përshkruese dhe financiare për vitin e kaluar,
- Raportin e revizionit,
- Biografite e të punësuarve kryesorë,
- Informata për partnerët dhe letrat e përkushtimit – në qoftë se ka.

Aplikimi i kompletuar duhet të dërgohet në zarf, me shënimin **“Thirrja për aplikime për projektin LLAQ”** dhe emrin e aplikuesit. Aplikimet duhet të dërgohen me postë ose të dorëzohen drejtpërdrejt në adresën e mëposhtme:

Fondacioni Metamorfozis

Rr. Apostoll Gusllarot, nr. 40, 1000 Shkup

Maqedoni

AFATI I FUNDIT për dorëzimin e aplikimeve është: **24 tetori i vitit 2016**